



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:090675

Datë: 08.07.2022

Numri i dokumentit: 03213589

P.nr.5/2013

NË EMËR TE POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË- Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues Mentor Hajraj, me zyrtaren ligjore Shqipe Sejdiu, në çështjen penale kundër të akuzuarve J.M, B.Sh, J.V dhe E.B për shkak te veprës penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.4 pika 1 e lidhur me par.2 të KPK-së, ndërsa i akuzuari B.Sh edhe për veprën penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës se Prokurorisë Publike të Qarkut ne Mitrovice, PP.nr.98/2012 te datës 07.12.2012, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 21.06.2022, i cili ka qenë i hapur për publikun, në të cilën kanë prezantuar prokurori i shtetit Naim Beka, të akuzuarit J.M, B.Sh, J.V dhe E.B, si dhe mbrojtësit e tyre av. Jetullah Berisha, av.Vehbi Beqiri, av. Xhelal Hasani dhe av.Leutrim Ademi, me datën 22.06.2022, ka marrë e më pas publikisht ka shpallur, ndërsa me datën 08.07.2022 e përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër te akuzuarve:

1.J.M i njohur me nofkën "...", i biri i ... dhe e vajzërisë ..., i lindur ... ne fshatin ... Komuna e ..., ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës, bujk, i martuar, ka te kryer shkollën e mesme , i gjendjes se dobët ekonomike, me numër personal ...

2.B.Sh i njohur me nofkën "...", i biri i ... dhe ... e vajzërisë ..., i lindur me ... ne fshatin ... Komuna e ..., ku edhe jeton Rr."...", shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës, kamerier, i

pamartuar, ka te kryer shkollën e mesme teknike, i gjendjes se mesme ekonomike, me nr. personal

3.J.V i njohur me nofkën "... , i biri i ... dhe ... e vajzërisë i lindur me .. ne ... Republika e ..., me vendbanim në Fushë Kosovë- Rr."...", Kompelsi "... Hyja .., Kati i ...-të, nr....., shqiptar, shtetas i Republikës se Kosoves, ndërtimtar, martuar, baba i dy fëmijëve ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, me nr. personal

4.E.B i biri i ... dhe ... e vajzërisë ..., i lindur me .. ne fshatin .. Komuna e ..., me vendbanim ne Rr."..."- ..., si dhe në fshatin ..- .., shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës, mekanik, i pamartuar, ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, me nr. personal

Të akuzuarit: J.M, B.Sh, J.V dhe E.B:

SHPALLËN FAJTOR

SEPSE: Me datën 12.03.2012 rreth orës 19:00 minuta , ne garazhin e automjeteve ne Qendrën Tregtare "ETC" ne Mitrovice, te akuzuarit te organizuar ne grup ne mënyrë te paautorizuar me qellim te shitjes dhe përfutimit material kane transportuar substanca te shpallura te rrezikshme si narkotike te llojit marihuane te cilat i kane sjell nga Peja per ne Mitrovice, te cilat i kane vendosur ne një qante sportive ngjyre te zeze me mbishkrimin " Sport" me gjithsej 11 paketime ne peshe te përgjithshme 11.316 kg dhe ate 1. 943.34 gr, 2. 924.33 gr, 3. 923.05 gr, 4. 940.92gr, 5. 941.37gr, 6. 886.34gr, 7. 944.35gr, 8. 924.30gr, 9. 957.70gr, 10. 901.83 gr, 11.920.99gr, ne ate menyre pasi qe J.M i ka sjell nga Shqipëria substanca narkotike te llojit marihuane te njëjtën e kane dërguar ne shtëpinë e te pandehurit B.Sh ne Terboviq te Pejës dhe pasi kane bere përgatitjen e paketimin e marihuanes ne qese te vogla me peshe si me larte, me te cilën sasi te marihuanes me qellim shitje ditën kritike rreth orës 16:00 nisen ne fshatin Katund i ri i Pejës për ne Mitrovice me tri automjete , dhe atë me automjetin "Golf 2" me tabela te regjistrimit 03-410-BL te cilën e drejtonte J.M me pasagjer Flamur Demiraj, ndërsa prapa tij me automjetin "Opel Vektra" me nr. te targave 03-927-CM e ka drejtuar B.Sh dhe i fundit ishte automjeti "VW Bora" me tabela nr. 03-189- BT" te ciline ka drejtuar E.B me pasagjer ... te cilët me automjetin e tyre kane transportuar substanca narkotike te marihuanes me peshe prej 11.316 kg deri te parkingu i marketit "ETC" ne Mitrovice me ç 'rast i pandehuri J.M nga i pandehuri ... i merr çelësat e automjetit "VW Bora" me targa 03-189-BT te cilën e ka drejtuar i pandehuri

.. dhe niset me te për ne garazhin e “ETC” dhe ndalon afër një automjeti, nxjerr çantën me gjithsej 11 paketime me marihuane te cilat i vendose ne atë automjet por hetohen nga policia dhe te pandehurit arrestohen ne flagrance, ndërsa J.M posa merr pagesën prej 7.200 euro nga shitja e narkotikeve ik nga vendi i ngjarjes por disa qaste me vone arrestohet nga policia ne një poste private ne rr. “Marin Barleti” ne Mitrovice.

Me këtë kanë kryer veprën penale: **Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psiko-tropike nga neni 229 par.4 pika 1 lidhur me par.2 të KPK-së.**

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 6, 11, 15, 34, 38, 39, 64, 66 par.1 pika 1.2, 67 par.1 pika 1.2, 73, dhe neni 229 par.4 pika 1 lidhur me par.2 të KPK-së, lidhur me nenet 361 dhe 365 te KPP-së, u:

SH Q I P T O N

Të akuzuarit J.M DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej dy (2) vjet, i cili dënim do te ekzekutohet pasi qe aktgjykimi te merr formën e prerë dhe **DËNIM ME GJOBË** ne lartësi prej 500 euro, i cili dënim do te ekzekutohet ne afatin prej 30 ditësh pasi qe aktgjykimi te merr formën e prerë.

Të pandehurit B.Sh DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej dy (2) vjet, i cili dënim do te ekzekutohet pasi qe aktgjykimi te merr formën e prerë dhe **DËNIM ME GJOBË** ne lartësi prej 500 euro, i cili dënim do te ekzekutohet ne afatin prej 30 ditësh pasi qe aktgjykimi te merr formën e prerë.

Të akuzuarit J.V DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej dy (2) vjet, i cili dënim do te ekzekutohet pasi qe aktgjykimi te merr formën e prerë dhe **DËNIM ME GJOBË** ne lartësi prej 500 euro, i cili dënim do te ekzekutohet ne afatin prej 30 ditësh pasi qe aktgjykimi te merr formën e prerë.

Të akuzuarit E.B DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej dy (2) vjet, i cili dënim do te ekzekutohet pasi qe aktgjykimi te merr formën e prerë dhe **DËNIM ME GJOBË** ne lartësi prej 500 euro, i cili dënim do te ekzekutohet ne afatin prej 30 ditësh pasi qe aktgjykimi te merr formën e prerë.

Koha e kaluar ne masën e paraburgimit per te akuzuarin J.M nga data 12.03.2012 deri me datën 02.04.2013, dhe koha e kaluar ne masën e paraburgimit për te akuzuarit J.V , E.B dhe B.Sh nga data 12.03.2012 deri me 06.09.2012 dhe arrest shtëpiak nga data 06.09.2012 deri me 03.12.2012, iu llogaritet ne dënimin e shqiptuar me burgim.

Nëse të akuzuarit dënimin e shqiptuar me gjobe nuk e paguajnë në afatin e përcaktuar nga gjykata, atëherë ne mbështetje te nenit 39 par.4 te KPK-se, ky dënim do te zëvendësohet ne dënim e me burgim, duke u llogaritur 15 euro të dënimit me gjobë barabartë me një dite burgimi.

Në batë të nenit 229 par. 5 të KPK-së, konfiskohet substancat narkotike e tipit marihuane ne peshe te përgjithshme 11.316 kg., substanca narkotike do te shkatërrohet nga Policia e Kosovës, pasi qe aktgjykimi te marr formën e prerë.

Në bazë të nenit 60 par.1 dhe par.2 të KPK-së, gjykata ndaj të akuzuarve J.M, E.B dhe B.Sh, shqipton:

DËNIM PLOTESUES-Marrja e sendit

Ne mënyre te përhershme nga i akuzuari J.M merret automjeti i markës Golf 2, ngjyre e kuqe, me targa 03-410-BL, çelësat dhe librezja e kësaj veture, si sende i përdorur ne kryerjen e veprës penale.

Ne mënyre te përhershme nga i akuzuari E.B merret automjeti i markës VW- Bora, ngjyre e kaltër, me targa 03-189-BT, çelësat dhe librezja e kësaj veture, si sende i përdorur ne kryerjen e veprës penale.

Ne mënyre te përhershme nga i akuzuari B.Sh merret automjeti i markës Opel Vectra, ngjyre e kaltër- metalike, me targa 03-927-CM, çelësat dhe librezja e kësaj veture, si sende i përdorur ne kryerjen e veprës penale.

Sipas nenit 182 par.4 te KPP-se, dorëzania e lënë nga i akuzuari J.M sipas aktvendimit te kësaj gjykate P.nr.5/2013 i dt.02.04.2013, ne këtë qeshje penale ne shume prej 10,000 (dhjetëmijë)

euro, te hiqet pasi qe aktgjykimi te merr formën e prerë dhe pasi qe i pandehuri te filloje vuajtjen e dënimit te shqiptuar me burgim.

Obligohen te akuzuarit secili veç e veç që në emër të shpenzimeve të procedurës penal dhe ate: ne emër te paushallit gjyqësor te paguajnë secili veç e veç shumen nga 20 euro, ne në emër të shpenzimeve secili veç e veç shumen nga 30 euro dhe ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimit secili veç e veç shumen prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Kërkesë pasurore juridike nuk ka pasur.

Në bazë te nenit 363 par.1 pika 1.1 te KPP-së, për veprën penale nën piken 2 të dispozitivit të aktakuzës të ri-cilësuar nga prokurori në shqyrtim fillestar *Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psiko-tropike nga neni 229 par.1 të KPK-së,* ne raport me te akuzuarin B.Sh:

REFUZOHET AKUZA

I akuzuari B.Sh:

SEPSE; Ne te njëjtën dite rreth orës 20:30 minuta, ne shtëpinë e tij ne fshatin ... te Komunës se ..., i pandehuri ne dhomën e tij te gjumit ne një raft te mobileve te dhomës ka poseduar me qellim te shitjes një sasi te substancave narkotike te llojit marihuane te mbështjella me qese najloni ngjyre e bardhe me mbishkrimin “Qendra Tregetare ETC” me peshe te përgjithshme prej 359.35 gr. te cilat gjate kontrollimit te shtëpisë dhe objekteve tjera ndihmese sipas urdhrit te GJPP te Gjykatës se Qarkut ne Mitrovice i është gjetur kjo sasi e narkotikeve e cila i është konfiskuar nga ana e policeve.

Me këtë kishte kryer veprën penale *Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psiko-tropike nga neni 229 par.1 të KPK-së.*

Te akuzuarit B.Sh, bazuar në dispozitën ligjore nga neni 282 par.1 dhe 2 pika 2.3 të KPK-së, i konfiskohen substancat narkotike e tipit marihuane ne peshe te përgjithshme 359.35 gr, substanca narkotike do te shkatërrohet nga Policia e Kosovës pasi qe aktgjykimi te marrë formën e prerë.

Kërkesë pasurore juridike nuk ka pasur.

A r s y e t i m i

-Aktakuza

Prokuroria Publike e Qarkut ne Mitrovicë, ka ngritur aktakuzë PP.nr.98/2012 te datës 07.12.2012, kundër të akuzuarve J.M, B.Sh, Flamur Demiraj, J.V dhe E.B për shkak te veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve te rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.4 pika 1 lidhur me par.2 te KPK-se, ndërsa i akuzuari B.Sh edhe për shkak te veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve te rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.2 te KPK-se e ne bashkim real me piken 1 te dispozitivit.

Në shqyrtim fillestar të mbajtur me datën 21.06.2022, prokurori i shtetit e bëri ri-kualifikimin e veprës penale sa i përket dispozitivit nën pikën II të aktakuzës në raport me të akuzuarin B.Sh, tani në veprën penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve te rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.1 te KPK-se, ku për shkak të kalimit të a fatit të parashkimit absolut të ndjekjes penale për këtë vepër të ri-kualifikuar prokurori u tërhiq nga ndjekja penale sa i përket kësaj vepre në raport me të akuzuarin B.Sh.

-Rrjedhja e procedurës

Kjo gjykate me aktgjykimin e saj P.nr.5/13, te dt.06.12.2019, te akuzuarit J.M, B.Sh, J.V dhe E.B, i ka shpallur fajtor për shkak te veprës penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.4 pika 1 e lidhur me par.2 të KPK-së, ndërsa te akuzarin B.Sh edhe për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.2 të KPK-së, dhe i ka dënuar sipas ligjit, ndërsa për te akuzuarin F.D me aktvendimin P.nr.5/13, te dt.12.11.2019, e ka veçuar procedurën penale.

Gjykata e Apelit të Kosovës me datën 13.03.2020, me Aktvendimin PAKR.nr.66/2020, këtë lëndë penale e ka kthyer në rigjykim.

Kjo gjykatë ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt.21.06.2022, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Naim Beka, të akuzuarit J.M, B.Sh, J.V dhe E.B, mbrojtësit e të tyre sipas detyrës zyrtare për të akuzuarin J.M- av.Jetullah Berisha për të akuzuarin J.V-

av.Xhelal Hasani, për të akuzuarin E.B- av.Leutrim Ademi, si dhe mbrojtësi i të akuzuarit B.Sh me autorizim av.Vehbi Beqiri.

Gjatë seancës së shqyrtimit fillestar të pandehurit janë udhëzuar dhe njoftuar me të drejtat e tyre konform nenit 246 par.1 të KPP-së, pas deklarimeve të të pandehurve është vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, më pas të njëjtit janë deklaruar se e kuptojnë akuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohen dhe pas bindjes së kryetarit të trupit gjykues se të pandehurit e kanë kuptuar akuzën, dhe pasi që janë njoftuar për pasojat dhe benificionet që parasheh ligji lidhur me pranimin e fajësisë, të pandehurit janë deklaruar se e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohen, pranimin e fajësisë e kanë bërë në mënyrë vullnetare, kanë shprehur keqardhje për rastin që ka ndodhur dhe i kanë premtuar gjykatës se nuk do të përsërisin veprime të tilla.

Në mbështetje të nenit 248 par.2 të KPP-së, është kërkuar mendimi i Prokurorit të Shtetit dhe i mbrojtësve të të akuzuarve lidhur me deklarin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve.

Prokurori i shtetit deklaroi se nuk ka pengesë që të aprovohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve, pasi që ky pranim fajësie gjen mbështetje edhe në shkresat e lëndës dhe i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë nga të akuzuarit.

Mbrojtësi i të akuzuarit J.M av.Jetullah Berisha deklaroi se është konsultuar me të mbrojturin e tij se i njëjti e ka pranuar në mënyrë vullnetare fajësinë, i propozoj gjykatës që të aprovohet pranimi i fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.Sh av.Vehbi Beqiri deklaroi se meqenëse i akuzuari që nga dita e parë në vazhdimësi e ka pranuar fajësinë i njoftuar edhe me pasojat e pranimi dhe mospranimi të fajësisë, vullnetarisht ka deklaruar se pranon fajësinë, i propozoj gjykatës që të aprovohet pranimi i fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit J.V av. Xhelal Hasani deklaroi se i propozoj gjykatës që të marrë aktvendim për pranimin e fajësisë, pasi që një deklarin i tillë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga ana e të akuzuarit.

Mbrojtësi i të akuzuarit E.B av.Leutrim Ademi deklaroi se meqenëse pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme nga i mbrojturi im dhe në pajtueshmëri me provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjykatës i propozoj që të bëjë pranimin e fajësisë nga i akuzuari.

Pas marrjes së mendimit nga Prokurori i Shtetit, dhe mbrojtësve të të akuzuarve, Kryetari i trupit gjykues është bindur se të akuzuarit e kuptojnë natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, andaj Kryetari i trupit gjykues në procesverbal në kuptim të nenit 248 par.4 e lidhur me par. 1 nën par 1.1,1.2,1.3,1.4 të KPP-së, ka marrë aktvendim duke pranuar pranimin e fajësisë, pasi që të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale, konkretisht në provat të cilat gjinden ne shkresat e lendes dhe atë: Raporti informues i policeve i dt. 12.03.2012, Raporti i policit i dt. 12.03.2012, Raporti i policeve i dt. 03.03.2012, Procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave dt. 12.03.2012, Lista e gjerave te konfiskuara nga J.M, E.B, si dhe ne emër te J.Vt e dt. 12.03.2012, Raporti i këqyrjes se vendit te ngjarjes dt. 12.03.2012 i shoqëruar me fotoalbum nga vendi i ngjarjes, Lista e dëshmimeve se bashku me zingjirin e ruajtjes nga Njësia Rajonale e Forenzikes ne Mitrovice, Raporti përmbyllës lidhur me zbatimin e masave te fshehta –përgjimet e telekomunikimeve te telefonisë mobile te pandehurve nga kompania “IPKO” dhe “VALA 900” e “Z MOBILE”, Raporti i ekspertizës se substancave narkotike nga Laboratori i Forenzikes te PK ne Prishtine me nr. AKF/2012-1564/2012-1359 dt. 14.08.2012.

Nga provat e cekura si me lart del se ne veprimet e te akuzuarve përmbushën ne tersi elementet e veprës penale për te cilën akuzohen te akuzuarit sipas aktakuzës, e rrjedhimit nga këto prova u vërtetua se të akuzuarit kanë kryer veprën penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve te rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.4 pika 1 lidhur me par.2 te KPK-se.

Prokurori i Shtetit, mbrojtësit dhe të akuzuarit nuk kanë pasur propozime apo plotësime në këtë çështje penale dhe pasi që Gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë për veprën penale nga të pandehurit dhe meqenëse nga palët nuk ka pasur propozime të reja për plotësimin e procedurës, Kryetari trupit gjykues e ka shpallur përfundimin e shqyrtimit fillestar dhe i ka njoftuar palët se gjykata do të vazhdojë në mbështetje të nenit 248 par. 4 të KPP-së, me shqiptimin e dënimit-respektivisht me shpalljen publike të aktgjykimit, e cila shpallja e aktgjykimit është bërë me datën 22.06.2022, në mungesë të palëve dhe mbrojtësve.

Duke vlerësuar përgjegjësinë penale të të akuzuarve në rastin konkret në raport me çështjen penale ndaj të njëjtëve nuk ekzistojnë rrethana të cilat kishin për të përjashtuar përgjegjësinë penale të të pandehurve në këtë çështje.

Me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë matjen e lartësisë së dënimit, në vështrim të nenit 64 të KPK-së,

Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin J.M., gjykata gjeti faktin se ky i akuzuar në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, faktin se ka bashkëpunuar në mënyrë korrekte me organet kompetente në të gjitha fazat e procedurës, se ka shprehur keqardhje për veprën e kryer penale, është penduar se e ka kryer këtë vepër dhe kane premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, pastaj faktin se i njëjti është familjar dhe se nga koha e kryerjes së veprës penale kane kaluar me shume se dhjet vite, ndërsa rrethane renduese gjykata gjeti faktin se i pandehuri veprën penale e ka kryer me dashje, shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë të të akuzuarit.

Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin B.Sh., gjykata gjeti faktin se ky i akuzuar në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, faktin se ka bashkëpunuar në mënyrë korrekte me organet kompetente në të gjitha fazat e procedurës, se ka shprehur keqardhje për veprën e kryer penale, është penduar se e ka kryer këtë vepër dhe kane premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale dhe se nga koha e kryerjes së veprës penale kane kaluar me shume se dhjet vite, ndërsa rrethane renduese gjykata gjeti faktin se i pandehuri veprën penale e ka kryer me dashje, shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë të të akuzuarit.

Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin J.V., gjykata gjeti faktin se ky i akuzuar në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, faktin se ka bashkëpunuar në mënyrë korrekte me organet kompetente në të gjitha fazat e procedurës, se ka shprehur keqardhje për veprën e kryer penale, është penduar se e ka kryer këtë vepër dhe kane premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, pastaj faktin se i njëjti është familjar dhe se nga koha e kryerjes së veprës penale kane kaluar me shume se dhjet vite, ndërsa rrethane renduese gjykata gjeti faktin se i pandehuri veprën penale e ka kryer me dashje, shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë të të akuzuarit.

Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin E.B., gjykata gjeti faktin se ky i akuzuar në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, faktin se ka bashkëpunuar në mënyrë korrekte me organet kompetente në të gjitha fazat e procedurës, se ka shprehur keqardhje për veprën e kryer penale, është penduar se e ka kryer këtë vepër dhe kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale dhe se nga koha e kryerjes së veprës penale kanë kaluar me shume se dhjet vite, ndërsa rrethane renduese gjykata gjeti faktin se i pandehuri veprën penale e ka kryer me dashje, shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë të të akuzuarit.

Ne rastin konkret kundër këtyre të akuzuarve gjykata vendosi që të aplikojë dispozitat e zbutjes së dënimit dhe të njëjtëve u shqiptojë dënimin me burgim si në dispozitiv të aktgjykimin nën minimumin e parapare ligjore për këtë vepër penale, duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 66 par.1 pika 1.2 të KPRK-se, pasi që gjykata gjeti rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se edhe me dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit (*kane bashkëpunuar në mënyrë korrekte me gjykatën, të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë në të gjitha fazat që nga marrja në pyetje në polici dhe kanë shfaqur keqardhje për veprën e kryer penale, janë penduar se e kanë kryer këtë vepër dhe kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra tjera penale, kanë krijuar familje dhe se nga koha e kryerjes së veprës penale kanë kaluar me shume se dhjet vite*).

Gjykata zbutjen e dënimit ndaj të akuzuarve e ka bere në kuadër të kufijve për zbutjen e dënimit të parapare në dispozitën ligjore nga neni 67 par.1 pika 1.2 të KPK-se, në të cilën parashihet ... nëse për vepër penale është parapare si mase me e ulet dënimi me burgim prej se paku tre (3) vjet, dënimi mund të zbutet deri në një (1) vit burgim.

Ne rastin konkret për veprën penale për të cilën të akuzuarit janë shpallur fajtor: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psiko-tropike nga neni 229 par.4 pika1 lidhur me par.2 të KPK-së, është parapare dënimi me gjobe dhe me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet. Pra siç shihet për këtë vepër penale kufiri i zbutjes së dënimit ka qenë dënimi me burgim prej një (1) viti, ndërsa gjykata të akuzuarve u ka shqiptuar dënim me burgim prej dy (2) vjet.

Sa i përket të akuzuarit B.Sh për veprën penale nën piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, *Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe*

substancave psiko-tropike nga neni 229 par.1 të KPK-së, pas heqjes dorë nga prokurori i shtetit nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit për këtë veprë penale ne shqyrtim fillestar, për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të ndjekjes penale, gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 363 parag.1 nën parag.1.1 të KPP-së, e ka refuzuar aktakuzën e Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë PP.nr.98/2012, të dt.07.12.2012.

Te akuzuarave J.M, J.V, B.Sh dhe E.B gjykata në pajtim me nenin 39 par.1, 2 dhe 3 të KPK-se i ka shqiptuar dënim me gjobe në shume prej nga pesëqind (500) euro, duke vlerësuar se një dënim i tillë është adekuat dhe në përputhje me gjendjen e tyre ekonomike.

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale për të cilën akuzohen të akuzuarit dhe se Gjykata ka vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllim i dënimit i paraparë me nenin 34 të KPRK-së, se të akuzuarit në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e paligjshme dhe do të bëjë rehabilitimin e tyre, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Në pajtim me nenin 73 par.1 të akuzuarave në dënimin me burg do t'iu llogaritet koha e kaluar në paraburgim për të akuzuarin J.M nga data 12.03.2012 deri me datën 02.04.2013, për të akuzuarit J.V , E.B dhe B.Sh koha e kaluar në paraburgim nga data 12.03.2012 deri me 06.09.2012 dhe arrest shtëpiak nga data 06.09.2012 deri me 03.12.2012.

Vendimin për konfiskimin e substancës narkotike, gjykata e ka marr në bazë të nenit 229 par. 5 të KPK-së, lidhur me nenin 282 par.1 dhe 2 pika 2.3 të KPK-se.

Vendimin për marrjen e automjeteve Golf 2, ngjyre e kuqe, me targa 03-410-BL, çelësat dhe libreza e kësaj veture, pastaj automjetit të markës VW- Bora, ngjyre e kaltër, me targa 03-189-BT, çelësat dhe libreza e kësaj veture, dhe automjetit të markës Opel Vectra, ngjyre e kaltër-metalike, me targa 03-927-CM, çelësat dhe libreza e kësaj veture, gjykata e beri në mbështetje të nenin 60 par.1 dhe par. 2 të KPK-se, pasi që të njëjtat janë përdorur në kryerjen e veprës penale për të cilën të akuzuarit janë shpallur fajtor, ngase nga shkresat e lëndes del se të akuzuarit narkotikun nga qyteti i Pejës në qytetin e Mitrovicës e kanë transportuar me këto automjete.

Gjykata në mbështetje të 182 par. 4 të KPP-së, vendosi që dorëzania e lënë nga i akuzuari J.M sipas aktvendimit të kësaj gjykate P.nr.5/2013 i dt.02.04.2013, në këtë qeshje penale në shume prej 10,000 (dhjetëmijë) euro, të hiqet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë dhe pasi që i pandehuri të fillojë vuajtjen e dënimit të shqiptuar me burgim.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 450, 451 dhe 453 të KPP-së, ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit në mbështetje të nenit 39 par.3 nën par.3.2 të Ligjit nr.05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sipas aktakuzës palë të dëmtuar nuk pati, andaj gjykata për kërkesën pasurore juridike nuk vendosi fare.

Nga të cekurat si më lart, duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 365 të KPP-se, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.5/13, me datën 08.07.2022

Zyrtare ligjore,
Shqipe Sejdiu

Kryetari i trupit gjykues
Mentor Hajraj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.